# Arjan Qafa

GJYQTAR PRANË GJYKATËS ADMINISTRATIV TË APELIT TIRANË

**Deklaratat e analizuara:**

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 45 herë.

+ 1,887,780 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




**Huadhënie**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga nga funksioni | 15,424,662 | 41.51% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 9,503,666 | 25.58% |
| Dhurata në Cash | 4,810,915 | 12.95% |
| Të ardhura të tjera | 7,416,598 | 19.96% |
| **Total** | **37,155,841** | **100%** |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**1 Me Probleme**
**13 Pa Probleme**

Në vitin 2008, bashkëshortja e subjektit deklaron për herë të parë pasurinë e saj prej 70,000 euro të krijuar ndër vite, por burimi I deklaruar nuk justifikon shumat e akumuluara Cash. Kontrolli aritmetik dhe logjik për këtë vit për subjektin dhe bashkëshorten e tij rezulton me një diferencë negative prej 1,634,000 lekë.
Gjatë periudhës deklaruese 2003-2017, konstatohen likuiditete cash në shuma të konsiderueshme, të cilat qarkullohen jashtë sistemit bankar në formë kursimesh, huadhëniesh dhe dhuratash, të pranishme pothuajse në çdo vit të deklarimit. Në total, kursimet cash kapin vlerën maksimale deri në 15,000,000 lekë shumë progresive, të cilat pakësohen kryesisht për investime në pasuri të paluajtshme. Huadhënia është në shumat 17,500 euro dhe 1,700,000 lekë, ndërsa dhuratat Cash nga të afërmit me rastin e martesës dhe në vijim për ditëlindjen e fëmijës arrijnë në vlerën 4,810,915 lekë.
Bashkëshortja Klodjana Qafa nga viti 2009 deri 2015 deklaron të ardhura nga një kontratë huaje, për të cilën nuk ka të dhëna se cilat janë palët, objekti dhe përmbajtja. Të ardhurat e përfituara nga kjo kontratë janë 7,416,598 lekë.